



**REPUBLIKA E KOSOVES
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIK OF KOSOVO**

**KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN**

Drejtorati për Buxhet dhe Financa- sektori i Tatimit në Pronë duke u mbështetur në Udhëzimin Administrativ 02/2019 për Procedurat Ankimore të Tatimit në Pronë, me gëllim të informimit të tatimpaguesit mbi Ankesat, kërkesat, mënyrën e parashtrimit të këtyre ankesave si dhe afatin e tyre , paraqet informatat në vijim.

Ankesat dhe Kërkesa për korrigjime

Nëse gjeni diçka gabim në Faturën e tatimit në pronë apo Certifikatën e vlerës së vlerësuar, ju keni të drejtë të dorëzoni një ankesë apo një kërkesë për korrigjime. Për të pasur efekt në tatimin e vlerësuar të vitit aktual, ju duhet të dorëzoni ankesë apo kërkesë për korrigjim më së voni deri më 31 Mars.

Nëse besoni që diçka në Faturën e tatimit në pronë apo në Certifikatën e vlerës së vlerësuar është e pasaktë, apo që tatimimi apo vlerësimi është bazuar në informata të pasakta, ju mund të dorëzoni një Ankesë apo Kërkesë për korrigjim.

31 Mars është një datë e rëndësisme për të pasur parasysh.

Ankesat

Data e fundit për të dorëzuar një Ankesë është 31 Mars. Ankesat të cilat miratohen do të ndikojnë tatimin e vitit aktual.

Kërkesë për korrigjim

Një kërkesë për korrigjim mund të dorëzohet në çdo kohë të vitit.

- Nëse ajo dorëzohet më së voni më 31 Mars të vitit tatimor – ajo do të trajtohet si ankesë dhe çdo ndryshim i miratuar do të ndikoj edhe në tatimin e vlerësuat të vitit aktual.
- Nëse ajo dorëzohet pas datës 31 Mars – çdo ndryshim i miratuar në regjistër do të ndikoj vetëm tatimin e vlerësuar për vitet në vijim.
- Nëse ajo dorëzohet pas datës 31 Tetor – ajo do të trajtohet si ankesë për vitin e ardhshëm tatimor.¹

Ekzistojnë 4 forma të ndryshme:

- Ankesë ndaj Certifikatës së Vlerës së Vlerësuar
- Ankesë ndaj Faturës së Tatimit në Pronë
- Ankesë Tjetër
- Kërkesë për Korrigjim

Ju mund të lexoni më shumë rreth secilës formë më poshtë.



Nëse diçka është e pasaktë në lidhje me vlerën e vlerësuar të pronës dhe kjo shpie në vlerësim të pasaktë tatimor, ju duhet të dorëzoni dy ankesa:

- Ankesa ndaj Certifikatës së vlerës së vlerësuar (për t'u siguruar që vlera është e saktë, dhe në këtë mënyrë bazë për tatimin në pronë për vitet e ardhshme është e saktë)
- Ankesa ndaj Faturës (për të bërë korrigimet në lidhje me tatimin e vlerësuar të vitit aktual).

Ju lutemi vëreni që edhe nëse keni dorëzuar një Ankesë apo një Kërkesë për Korrigjim, ju prapë duhet të paguani tatimin, gjobat dhe borxhet sipas Faturës.

Dorëzimi i formave

Ju mund të dorëzoni Ankesat tuaja:

- Personalisht në komunën ku gjendet prona
- Personalisht në Ministrinë e Financave
- Përmes shërbimit postar, apo në mënyrë elektronike

Ju mund të dorëzoni Kërkesën tuaj për Korrigjime:

- Personalisht në komunën ku gjendet prona
- Përmes shërbimit postar, apo në mënyrë elektronike

Ankesa ndaj Certifikatës së vlerës së vlerësuar


Ju duhet të shfrytëzoni këtë formë nëse në Certifikatën e vlerës së vlerësuar keni gjetur ndonjë prej sa vijon:

- Kategoria e vlerës së objektit apo parcelës është e pasaktë
- Zona e vlerës është e pasaktë
- Sipërfaqja është e pasaktë
- Standardi i gjendjes së një objekti është i pasaktë
- Gabime tjera në regjistrin e tatimit në pronë, në të cilin është bazuar Certifikata.
- Certifikata e vlerës së vlerësuar është në kundërshtim me dispozita tjera të Ligjit të Tatimit në Pronë apo Udhëzimet administrative.

Ankesat ndaj faturës së tatimit në pronë

Ju duhet të shfrytëzoni këtë formë nëse në Faturën e tatimit në pronë gjeni ndonjë prej sa vijon:

- Tatimpaguesi përgjegjës është i pasaktë
- Lirim i nga tatimi në pronë sipas nenit 10 të Ligjit të Tatimit në Pronë nuk është implementuar
- Vlera e tatimueshme është e pasaktë.
- Norma tatimore është e pasaktë.
- Gjobat në përputhje me nenin 35: 2-5 të Ligjit të Tatimit në pronë janë imponuar gabimisht
- Gabime tjera në regjistrin e tatimit në pronë, në të cilën është bazuar Fatura e Tatimit në Pronë.



- Fatura e Tatimit në Pronë është në kundërshtim me dispozita tjera të Ligjit të Tatimit në Pronë apo Udhëzimet administrative.

Ankesat tjera

Ju duhet të shfrytëzoni këtë formë nëse keni ankesa tjera përveç atyre të specifikuara më lartë.

Kërkesa për korrigjim

Ju mund të shfrytëzoni këtë formë kur dëshironi të bëni korrigjime në regjistrin e tatimit në pronë.

- Gabime në shkrim apo në llogaritje
- Gabime në lidhje me tatimpaguesin përgjegjës
- Gabime në lidhje me sipërsfaqen
- Gabime në lidhje me klasifikimin
- Gabime në lidhje me pikën e lokacionit të pronës
- Gabime tjera në regjistrin e tatimit në pronë.

¹ Tatimi i vlerësuar është bazuar në informatat në regjistra në datën e karakteristikave, e cila është 30 Nëntor. Një kërkesë për korrigjim e cila është dorëzuar pas datës 31 Tetor nuk mund të trajtohet me kohë para datës 30 Nëntor. Kjo domethënë që tatimi mund të vlerësohet bazuar në informata të vjetra, të pasakta në regjistër. Prandaj, fatura të cilën e pranoni në Janar mund të jetë e pasaktë por kërkesa juaj për korrigjim do të trajtohet si ankesë. Kjo ankesë, nëse miratohet, do të shpie në rivlerësim të tatimit sipas faturës.